

## Republika Kosovo - Republic of Kosovo

### Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Roza Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, u.d e Drejtorit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave MAPL	Datë: 02/04 /2019 Nr. 020-310
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Vendim	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,


Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim nr.111/01-16567 për formimin e panelit përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e komiteteve konsultative komunale Për zhvillimin ekonomik, mbrojtje të ambientit, shëndeti dhe mirëqenies Sociale

I miratuar më datë: 27.03.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 28.03.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit të komunës së lart cekur, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



# Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Ramiz Lladrovci, gradonačelnik Opštine Glogovac Labinot Halilaj, predsedavajući Skupštine opštine Glogovac	
Cc:	Jednici za administraciju dokumenata u MALS-u Jednici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Venera Čerkini, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština- MALS	Datum, 02.04.2019.
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine	Br. 020-310
Vrsta akta:	<input type="checkbox"/> Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačleniče,  
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obaveznu rapsravu zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-40 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br.111/01-16567 za formiranje oizbornog panela za razvijanje procedura za osnivanje opštinskih konsultativnih odbora za ekonomski razvoj, zaštitu sredine zdravlja i blagostanja.
Usvojena dana, 27.03.2019. godine,
Predložena za razmetranje u MALS-u dana, 28.03.2019. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni efekat.

Ministartstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**Komuna e Drenasit**  
**Kuvendi i Komunës**

12 Nr. 1111-16567 dt 27/03/2019

REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E DRENASIT  
Municipality of Drenas  
Ministry of Local Government Administration  
Date: 28.03.2019  
No. of organization: 01-020-310



Në bazë të nenit 11,12, dhe 40 dhe nenit 73 të ligjit për vetëqeverisje lokale, si dhe nenit 4, 7, 8, 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2016 për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna si dhe nenit 34 pika 34.6 të statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë: 27.03.2019, aprovoi këtë:

**V E N D I M**

**Për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetin Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

**Neni 1**

Më këtë Vendim Kuvendi i Komunës formon panelin përzgjedhës, i cili do të zhvilloj procedurat për themelimin e komitetit konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve si:

1. Malsore Cakiqi- anëtar nga Kuvendi
2. Petrit Sinani- anëtar nga Kuvendi
3. Sokol Bylykbashi- anëtar nga Kuvendi
4. Haki Bekolli- anëtar nga ekzekutivi
5. Behxhet Binaku- anëtar nga shoqëria civile

**Neni 2**

Kuvendi ka për obligim të themelon panelin përzgjedhës, i cili duhet të ketë në përbërje tre anëtare të kuvendit të komunës, një anëtarë nga ekzekutivi i komunës dhe një anëtarë nga shoqëria civile, që do t'i propozojnë kuvendit të komunës listën me anëtarë për komitetin konsultativ.

**Neni 3**

Për zgjedhjen e anëtarëve në komitetin konsultativ kuvendi i komunës shpall konkurs publik dhe përcakton kriteret për konkurrim.

#### Neni 4


Mandati i komitetit konsultativ pas përzgjedhjes është 4 vjeçar, nga themelimi i komitetit.

#### Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

  
Labir Halilaj